



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, me 22 prill 2010, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Kolë Berisha, Dzezair Murati, Fatmire Berisha, Ahmet Isufi, Suzan Novobrdaliu, Besa Gaxherri dhe Vladimir Todorovic.

Mungoi: Ramadan Gashi

Të ftuar në mbledhje të Komisionit ishin Gani Koci – Kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Haki Shatri – Kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pjesëmarrës të tjerë: Artan Venhari – KIPRED, Reshid Gashi – NDI, Isuf Zejna – KDI, Lumnije Murati ZPRK, Floriana Shala OSBE dhe Teuta Rexhepi – Bota Sot.

Nga Divizioni për mbështetje komisioneve parlamentare: Xheladin Hoxha dhe Manush Krasniqi

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni - Kaloshi - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 31 mars 2010;**
- 3. Plotësimi i Raportit me rekomandime lidhur me Projekt-rregulloren e Kuvendit (shpërndarë deputetëve me 14.04.2010);**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 31 mars 2010.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 31 mars 2010, u miratua pa vërejtje.

3. Plotësimi i Raportit me rekomandime lidhur me Projekt-rregulloren e Kuvendit (shpërndarë deputetëve me 14.04.2010);

Hydajet Hyseni paraqiti disa propozimamendamente në Projekt-rregulloren e Kuvendit lidhur me fushëveprimin e Komisioneve, përkatësisht atë të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Lidhur me propozimamendamentet në Projekt-rregulloren e Kuvendit dhe fushëveprimin këtyre Komisioneve, diskutuan: Hydajet Hyseni, Gani Koci, Ahmet Isufi, Haki Shatri dhe Ismet Krasniqi.

Komisioni, pas shqyrtimit të propozim amendamenteve, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, që t'i miratojë amendamentet plotësuese në Projekt-rregulloren e Kuvendit, si në vijim:

Amendamenti 1

(Ky amendament votohet pas amendamentit 38)

Në rregullën 53, pika 8, fjalët “një javë pune”, zëvendësohen me “10 ditë pune”.

Amendamenti 2

(Ky amendament votohet pas amendamentit 55)

Në shtojcën nr. 4, në rregullën 3, pika 3, fshihet fjalët “të paarsyeshme në ndonjërin nga”.

2. Teksti i harmonizuar i fushëveprimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të inkorporohet në shtojcën 2 të Projekt-rregullores së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12.15.

E hartoi:

Njësia për mbështetje të Komisionit.

Kryetari i Komisionit
Hydajet Hyseni – Kaloshi
